



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në mbështetje të nenit 12.2 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, nenit 2.9 të Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor, nr. 02/L-70 dhe nenit 15.2 shkronja c të Statutit të Komunës, nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2014, miratoi,

RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR KUSHTET DHE MËNYRËN E BLOKIMIT DHE ZHVENDOSJES SË AUTOMJETEVE

Neni 1

Rregullorja për kushtet dhe mënyrën e bllokimit dhe zhvendosjes së automjeteve, ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

Neni 20 parag. 1

“Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e punëve në përmbushjen e obligimeve të operatorit konform dispozitave të kësaj Rregulloreje”.

Zëvendësohet me tekstin:

“Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Drejtoria e Inspeksionit janë përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e punëve sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje”

Neni 20 parag. 2

“ Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit është përgjegjëse për mbikëqyrje dhe kontroll në aspektin financiar mbi bazat e Ligjit për menaxhimin e Financave publike dhe përgjegjësitë”,

zëvendësohet me tekstin:

“ Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, përgatit raporte financiare, periodike dhe vjetore, për mjetet e arkëtuara sipas kushteve të kontratës në kuadër të raporteve për të hyrat e Komunës”.

Neni 20 parag. 3

“ Drejtoritë e cekura në këtë nen, në funksion të mbarëvajtjes së punëve, mund të nxjerrin udhëzime përkatëse të cilat janë të obliguara për operatorin”.

Fshihet në tërësi.

Neni 2

Kjo Rregullore është pjesë përbërëse e Rregullores për kushtet dhe mënyrën e bllokimit dhe zhvendosjes së automjeteve, nr. 01-1/280-110 të datës 28 shtator 2009.

Neni 3

Rregullorja hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë, përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-346-64153
Podujevë,
31 korrik 2014



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi